

KQZ  
U PROTOKOLLUA  
Nr. 3747 Prot.  
Datë, më 13. 4. 2023

**RAPORTI FINAL I AUDITUESIT**  
**MBI VERIFIKIMIN E VEPRIMEVE NE BAZËN E TE DHËNAVE TE**  
**REGJISTRIT KOMBËTAR TE GJENDJES CIVILE**

Përgatiti:  
Laert Kraja  
Audit Teknikien



Lënda : **Raporti Auditimit**

Drejtuar : **Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**  
**Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror për Zgjedhje**

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 2, datë 14.12.2022, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet të datës 14 Maj 2023" dhe udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju paraqes më poshtë raportin e auditimit të kryer për periudhën ekstraktin e parë datë 22 Nëntor 2022, ekstraktin e dytë datë 19 Dhjetor 2022, ekstraktin e tretë 21 Janar 2023, të katërt 19 Shkurt 2023, të pestin 20 Mars 2023 dhe listën perfundimtare 4 Prill 2023.

Verifikimet paraprake mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhore e listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) në zbatim të "Kodit Zgjedhor", Ligjit "Për Gjendjen Civile", janë kryer duke përdorur metodën e testimit dhe krahasimit nëpërmjet përkëmbimeve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Për përmbushjen e misionit të ngarkuar kam vlerësuar metodat dhe parimet e përdorura për kontrollin e dublimeve në listat e zgjedhësve sipas procedurave të parashikuara në aneksin nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", respektimin e kriterit ligjor për numrin e zgjedhësve për qendrat e votimit si dhe kriteret e tjera të vendosur në ligj.

Përgjegjësia e audituesit është të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për "Gjendjen Civile" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.



## **Përmbajtje**

1. Hyrje .....	5
2. Baza Ligjore .....	7
3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake .....	8
4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve. ....	11
4.1. Shtetas të pa identifikuar, me kode banimi jo të rregullta. ....	11
4.2. Shtetas me QV të ndryshuar nga Ekstrati 2 .....	12
4.3. Shtetas me kod banimi të njëjtë por votues në QV të ndryshme.....	15
4.4. Sistemi i adresave.....	17
5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore .....	20
6. Opinion .....	22
7. Shtojca .....	22



## 1. Hyrje

Ne kuadër të zgjedhjeve, sipas dekretit Nr.1386 të Presidentit të Republikës, datë 24.10.2022, do të zhvillohen më datë 14 Maj 2023 nëpërmjet vendimit Nr. 2, datë 14.12.2022, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve është bere caktimi i auditit teknikien është bere caktimi im si Auditues Teknikien.

E gjithë puna është bazuar dhe do të bazohet në përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për Miratimin e Rregullave të Veçanta,për Kushtet e Kontratës dhe Kryerjen e Auditimit,nga Auditët Teknikien,për Verifikimin e Veprimeve në Bazën etë Dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe në Sistemin Elektronik të Verifikimit dhe Regjistrimit Të Zgjedhësve (SEV)"; i cili në nenin 7 përcakton objektin, në lidhje me verifikimet e veprimeve në bazën e të dhënave, si më poshtë:

*Objekt i auditimit nga auditët teknikien është kontrolli i përputhshmërisë së veprimeve të kryera për hartimin e listave të zgjedhësve nga zyrat e gjendjes civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me rregullat dhe afatet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për Gjendjen Civile si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre të nxjerra nga Ministri i Brendshëm.*

Me qëllim realizimin e kësaj objektive, puna jonë është përqendruar në verifikimin e të gjithë elementëve të listave të zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, në lidhje meekzistencës dhe saktësisë e të dhënave për të gjithë ata shtetas të cilët gëzojnë të drejtën që të jenë zgjedhës, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.

Ne zbatim të detyrës të caktuar kontrolli i ekstraktit të përbërësve zgjedhor përfshin ne përgjithësi:

- Njohjen dhe verifikimi i procedurave të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë të Brendshme, Zyrave e Gjendjes Civile pranë Bashkive dhe Njësi Administrative, si dhe të strukturave të tjera të pushteti vendor, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në përgatitjen e listës së zgjedhësve.

- Verifikimi mbi masat e ndërmarra për sigurimin e integritetit të bazës së të dhënave dhe mbi procedurat e mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.
- Kryerjen e verifikimeve mbi veprimet kryera nga shërbimi i Gjendjes Civile të cilat ndikojnë në elementët zgjedhorë, sipas përcaktimeve të nenit 45, të ligjit nr. 10019 me datë 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndryshuar.



## 2. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020.
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"
- VKM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik".
- VKM Nr.673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'"
- VKM Nr. 710 datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit" i ndryshuar,
- VKM 222 date 26.4.2018 "Për miratimin e listës se infrastrukturave kritike te informacionit dhe listës se infrastrukturave te rëndësishme te informacionit"
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.11152, datë 28.10.2022 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore".
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit

Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)

### **3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake**

Duhet theksuar që në fillim se me marrjen e detyrës kemi zhvilluar takimin e parë më datë 27 dhjetor me zyrtarët kryesorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të siguruar kushtet minimale të punës dhe për të marrë informacionet bazë të nevojshme për zhvillimin e punës sonë. Që në takimin e parë dhe në vazhdim janë kërkuar

1. Përcaktimi i një posti pune pranë DPGJC dhe aksesit në Sistemin Informatik të Regjistrimit Kombëtar të Shtetasve, dhe/apo sisteme të lidhura me të.
2. Kopje zyrtare të Extraktit të Listës së Zgjedhësve dhe statistikat përkatëse.
3. Informacion mbi procesin e përditësimit të adresave të shtetasve
4. Informacion mbi procedurat e realizuara në lidhje me reflektimin në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve (RKSH) të dekreteve të Presidentit të Republikës për dhënie/marrje shtetësie
5. Statistika mbi të dhënat për QV-të të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore.

Gjithashtu më datë 04 Janar 2023 kam marrë ekstraktet e përbërësve zgjedhorë të gjeneruara në datën 22 Nentor 2022, dhe sipas datave 19 Dhjetor 2022, e më pas me 21 Janar 2023, 19 Shkurt 2023, 20 Mars 2023 dhe 4 Prill 2023 si edhe statistikat nga DPGJC në po të njëjtat data.

Bazuar në statistikat e përgatitura nga ana DPGJC-së për ekstraktet, ekstraktit të parë (Ekstrakt 1) gjeneruar në datën 22 Nentor 2022, ekstraktit të dytë (Ekstrakt 2) të gjeneruar në datë 19 Dhjetor 2022 dhe ekstraktit të tretë (Ekstrakt 3) të gjeneruar në datë 21 Janar 2023 gjithashtu ekstraktin e katërt (Ekstrakt 4) të gjeneruar në datë 19 Shkurt 2023, ekstraktin e pestë (Ekstrakt 5) të gjeneruar në datë 20 Mars 2023 dhe listën përfundimtare (Lista Perf.) me datë 4 Prill 2023 na janë venë në dispozicion të dhënat e përgjithshme si më poshtë:



Raporti final i Audituesit Teknikien

Nr	Përshkrimi	Ekstrakt 1	Ekstrakt 2	Ekstrakt 3	Ekstrakt 4	Ekstrakt 5	Lista Finale
1	Numri i përgjithshëm i shtetasve me të drejtë votimi	3,660,605	3,658,880	3,656,301	3,653,988	3,652,010	3,650,550
	a. Meshkuj	1,848,733	1,847,803	1,846,469	1,845,198	1,844,164	1,843,170
	a. Femra	1,811,872	1,811,077	1,809,832	1,808,790	1,807,846	1,807,380
	b. Votues per here 1	-	-	-	122,540	122,546	122,545
2	Të pa përfshirë në lista ( për shkak të qendrave jashtë limitit) nga të cilët:	115,514	25,218	2,738	2,476	2,753	-
	a. Shtetas mbi 100 vjeç të pa përfshirë	3,845	3,827	3,795	3,779	3,737	3,717
	b. Shtetas të pa përfshirë sipas udhëzi mit nr. 225 datë 11.05.2016	754	750	752	805	746	1,111
	c. Të tjerë me numër QV jashtë limitit	115,514	25,218	2,738	2,476	2,753	-

Raporti final i Audituesit Teknikien

3	Numri i Votuesve në listë	3,545,091	3,633,662	3,653,563	3,651,512	3,649,257	3,650,550
4	Numri i QV-ve në total	5,096	5,198	5,193	5,194	5,198	5,211
5	Numri i QV-ve mbi 1,000 zgjedhës	104	22	1	1	2	-
6	Numri i QV-ve nën 300 zgjedhës, nga të cilat	279	33	8	7	3	-
	a. 15-300 zgjedhës (QV të veçant a)	3	3	3	6	9	14
	b. Më pak se 15 zgjedhës	276	30	5	1	-	-
7	Numri i zgjedhësve me numër banimi 000 888 999	5,365	1,367	648	590	169	433

Në një vështrim të përgjithshëm nga treguesit e mësipërm rezulton se:

1. Kemi rritje të numrit të shtetasve me të drejtë vote nga Ekstrakt 5 në Listën përfundimtare me 1,293 zgjedhës.
2. DPGjC dhe Bashkitë kanë eliminuar 100% të qendrave të votimit me më pak se 300 votues dhe më shumë se 1000 votues, gjithashtu dhe QV me më pak se 15 zgjedhës kemi 0 QV, të cilat janë numra të gabuar dhe jashtë njësisë Administrative respektive, janë pastruar plotësisht.
3. Ka një rritje të numrit të shtetasve me kodet banimi 000, 888 dhe 999 nga 169 shtetas në Ekstraktin 5 në 433 shtetas të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve. Do të thote që 264 votues të shtuar që kanë kod banimi (000,888,999) tashmë në liste.

#### 4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.

##### 4.1. Shtetas të pa identifikuar, ose me kode banimi jo të rregullta.

Bazuar edhe në analizat e kryera që në vitin 2019, dhe ne 2021 në listat për Zgjedhjet, fenomeni numrit të banesës (kodi i banimit) 000, 888 dhe 999 pothuajse nuk ekziston më. Në Listen perfundimtare praktikisht kemi vetëm 433 shtetas me kod banese të pa identifikuar. Por fakti që për ata zgjedhës të cilët kanë pasur kod banese të pa identifikuar deklarohen kode të rinj të cilët janë mbi nivelet e listave të mëparshme duke arritur deri në kodin 998 krijon dyshime të mëdha për ndryshime fiktive dhe manipulim të vlerave të kodit të banesës për zgjedhësit në fjalë. Fenomen ky i evidentuar dhe ne raportet e auditit teknikien te depozituara dhe kryera në vitin 2021. Rezulton se **178,550** zgjedhës kane kod banese mbi 350 dhe **73,517** zgjedhës më të madh se 500. Detajet për këta shtetas për çdo bashki janë si ne në tabelën e mëposhtme. Nga investigimet e kryera dhe bazuar dhe ne raportet e 2019 dhe 2021 kemi krijuar bindjen se procesi i ndërmarrë nga DPGJC për këto kode ka qene totalisht abuziv dhe kodet ne shumicën dërrmuese te rasteve janë kode fiktive, ashtu sikurse kemi edhe votues me kod banimi në objekte jo banuese (objekte social kulturore, arsimore, industriale, etj.).

Nr.	Qarku	Kod Banese > 350	Kod Banese > 500
1	Berat	2,872	881
2	Dibër	156	139
3	Durrës	23,057	10,975
4	Elbasan	17,250	9,500
5	Fier	11,042	4,887
6	Gjirokastrë	1,534	277
7	Korçë	33,123	13,323
8	Kukës	935	271
9	Lezhë	4,952	932
10	Shkodër	12,035	4,985
11	Tiranë	57,905	22,976
12	Vlorë	13,689	4,371
<b>Total</b>		<b>178,550</b>	<b>73,517</b>

Duke e konsideruar si element me risk te lartë kemi kërkuar informacion DPGjC mbi kodin e baneses dhe procedurën se si vendosen kodet e banesave pasi kemi një përbërës te kodit zgjedhor 10 shifror nga ana e DPGJC skemi marrë përgjigje.

Bazuar në faktin se DPGjC ka kryer tashmë një proces të përditësimit të adresave, në mënyrë automatike pyetja që shtrohet është kur DPGjC ka identifikuar mbi 2 milion shtetas në banesa dhe ka përditësuar në RKGjC adresat e tyre pse nuk ka saktësuar fillimisht shtetasit me probleme historike te kodit te banesave por ne vitin 2018 ka ndërmarrë një operacion te gjere për te zëvendësuar fiktivisht kodet 999,888 etj. me kode te reja. Kjo pyetje nuk ka marre përgjigje shteruese as gjate raporteve te vitit 2021.

#### 4.2. Shtetas të cilët i ka ndryshuar QV nga Ekstrakti 2 në Listën Përfundimtare

Bazuar në faktin se DPGjC ka kryer përditësimit të listës zgjedhore emërore pyetjes tonë mbi procedurat e ndjekura dhe anën teknike e cila është ndjekur për të nxjerrë ekstraktin 3, 4 dhe 5 kemi marrë një përgjigje jo të plotë mbi procedurat e ndjekura për këto ekstrakte, sipas DPGJC eshte ndjekur Udhezimi i Ministrisë te Brendshem nr. 207, datë 28.10.2022 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore", i cili vazhdon të ketë **te ndryshuar QV e 1,276,418** zgjedhësve, **35% të totalit** të listës nga Ekstrakti 2 në Ekstraktin 3, deri në Listën Përfundimtare

Bashkia	Zgjedhes me QV te ndryshuar	Zgjedhes Total	Zgjedhes Total
Bashkia Kamëz	67,576	108,799	62%
Bashkia Sarandë	25,747	47,999	54%
Bashkia Durrës	142,078	265,864	53%
Bashkia Tiranë	373,902	699,766	53%
Bashkia Vorë	14,342	30,822	47%
Bashkia Vlorë	74,564	167,688	44%
Bashkia Lezhë	39,910	90,517	44%



<b>Bashkia Korçë</b>	40,425	109,577	37%
<b>Bashkia Shijak</b>	13,221	37,296	35%
<b>Bashkia Roskovec</b>	9,032	25,819	35%
<b>Bashkia Himarë</b>	7,583	22,822	33%
<b>Bashkia Pogradec</b>	24,216	73,356	33%
<b>Bashkia Gjirokastër</b>	14,042	43,316	32%
<b>Bashkia Kavajë</b>	21,431	66,467	32%
<b>Bashkia Delvinë</b>	4,762	14,830	32%
<b>Bashkia Konispol</b>	3,607	11,386	32%
<b>Bashkia Elbasan</b>	53,056	171,225	31%
<b>Bashkia Patos</b>	10,634	34,532	31%
<b>Bashkia Kurbin</b>	17,641	58,574	30%
<b>Bashkia Kuçovë</b>	13,508	45,303	30%
<b>Bashkia Dimal</b>	9,322	31,540	30%
<b>Bashkia Divjakë</b>	12,654	43,631	29%
<b>Bashkia Fier</b>	48,106	167,730	29%
<b>Bashkia Krujë</b>	18,385	65,041	28%
<b>Bashkia Lushnje</b>	28,862	105,463	27%
<b>Bashkia Shkodër</b>	45,879	169,539	27%
<b>Bashkia Berat</b>	21,529	81,078	27%
<b>Bashkia Kolonjë</b>	3,834	15,098	25%
<b>Bashkia Rrogozhinë</b>	8,165	32,826	25%



<b>Bashkia Prrenjas</b>	5,965	25,445	23%
<b>Bashkia Malësi e Madhe</b>	9,104	45,906	20%
<b>Bashkia Mat</b>	5,639	29,292	19%
<b>Bashkia Devoll</b>	6,277	33,724	19%
<b>Bashkia Përmet</b>	2,861	16,122	18%
<b>Bashkia Librazhd</b>	5,634	33,249	17%
<b>Bashkia Maliq</b>	8,254	49,507	17%
<b>Bashkia Poliçan</b>	2,130	12,953	16%
<b>Bashkia Libohovë</b>	923	5,884	16%
<b>Bashkia Cërrik</b>	5,887	37,710	16%
<b>Bashkia Peqin</b>	4,454	30,671	15%
<b>Bashkia Dropull</b>	2,835	19,884	14%
<b>Bashkia Finiq</b>	4,349	31,039	14%
<b>Bashkia Mallakastër</b>	3,834	31,056	12%
<b>Bashkia Gramsh</b>	3,289	27,020	12%
<b>Bashkia Mirditë</b>	3,325	27,698	12%
<b>Bashkia Has</b>	1,903	16,543	12%
<b>Bashkia Pustec</b>	491	4,364	11%
<b>Bashkia Këlcyrë</b>	1,012	9,308	11%
<b>Bashkia Bulqizë</b>	3,215	29,672	11%
<b>Bashkia Tepelenë</b>	1,368	12,645	11%
<b>Bashkia Belsh</b>	2,818	26,135	11%



<b>Bashkia Kukës</b>	4,328	45,828	9%
<b>Bashkia Memaliaj</b>	1,428	15,647	9%
<b>Bashkia Dibër</b>	5,046	56,726	9%
<b>Bashkia Selenicë</b>	2,193	27,053	8%
<b>Bashkia Skrapar</b>	931	13,269	7%
<b>Bashkia Pukë</b>	703	11,627	6%
<b>Bashkia Klos</b>	586	15,592	4%
<b>Bashkia Vau-Dejës</b>	819	39,975	2%
<b>Bashkia Tropojë</b>	-	22,285	0%
<b>Bashkia Fushë-Arrëz</b>	-	8,817	0%
<b>Total</b>	<b>1,269,614</b>	<b>3,650,550</b>	<b>35%</b>

#### 4.3. Shtetas të cilët kanë kod banimi të njëjtë por votojnë në QV të ndryshme

Në vazhdim të problematikës së ndryshimit të QV të **1,269,614** shtetasve me të drejtë vote është pyetur DPGJC mënyra që është përdorur për hartimin e listave dhe ndarjen e votuesve sipas QV përkatëse dhe nga ana e DPGJC kemi marrë një përgjigje si më poshtë:

Në bazë të përcaktimeve sipas pikës 3/1 të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 207, datë 28.10.2022 *“Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore”*, ku parashikohet:

*“Caktimi i zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit dhe renditja e tyre Brenda qendrës së votimit sipas rendit alfabetik të mbiemrit”.*

Pra shtetasit me të njëjtin kod të vendbanimit duhet të ishin votues në të njëjtën Qender Votimi. Pas një kontrolli mbi kodet e banimit vejmë re se kemi raste në **58**

**bashki** të votuesve me të njëjtin kodbanimi të cilët votojnë në QV të ndryshme, ndërkohë në bazë të përgjigjes të marrë nga DPGJC ky numër duhet te ishte **0**.

Bashkia	Nr i rasteve qe I njejti kodbanimi ndodhet ne dy ose me shume fraksione
Bashkia Tiranë	2193
Bashkia Durrës	800
Bashkia Kamëz	507
Bashkia Sarandë	496
Bashkia Dibër	488
Bashkia Kukës	240
Bashkia Vlorë	235
Bashkia Fier	198
Bashkia Shkodër	190
Bashkia Korçë	186
Bashkia Lezhë	167
Bashkia Krujë	153
Bashkia Elbasan	142
Bashkia Lushnje	134
Bashkia Pogradec	128
Bashkia Berat	84
Bashkia Vorë	80
Bashkia Gjirokastrë	68
Bashkia Kurbin	54
Bashkia Kavajë	54
Bashkia Malësi e Madhe	52
Bashkia Librazhd	50
Bashkia Kuçovë	36
Bashkia Shijak	34
Bashkia Patos	32
Bashkia Himarë	32
Bashkia Maliq	28
Bashkia Divjake	26
Bashkia Mat	24
Bashkia Prrenjas	22
Bashkia Delvinë	20
Bashkia Gramsh	18
Bashkia Konispol	18
Bashkia Ura Vajgurore	18





<b>Bashkia Mallakaster</b>	18
<b>Bashkia Rrogozhinë</b>	18
<b>Bashkia Rroskovec</b>	16
<b>Bashkia Devoll</b>	16
<b>Bashkia Mirditë</b>	16
<b>Bashkia Cërrik</b>	14
<b>Bashkia Poliçan</b>	14
<b>Bashkia Has</b>	14
<b>Bashkia Përmet</b>	12
<b>Bashkia Bulqizë</b>	12
<b>Bashkia Kolonjë</b>	10
<b>Bashkia Finiq</b>	10
<b>Bashkia Peqin</b>	8
<b>Bashkia Vau i Dejës</b>	8
<b>Bashkia Skrapar</b>	6
<b>Bashkia Memaliaj</b>	6
<b>Bashkia Belsh</b>	4
<b>Bashkia Klos</b>	4
<b>Bashkia Selenicë</b>	4
<b>Bashkia Tepelenë</b>	4
<b>Bashkia Libohovë</b>	2
<b>Bashkia Dropull</b>	2
<b>Bashkia Kelcyre</b>	2
<b>Bashkia Pukë</b>	2
<b>Total</b>	<b>7.229</b>

#### 4.4. Sistemi i Adresave

Duke u nisur nga problematikat e evidentuara në Sistemin RKGJC në aspektin e adresave edhe nga auditet teknike të mëparshëm, u konstatua një numër i konsiderueshëm votuesish me adresë të pasaktë (mungesë e përbërësve të adresës) që për rrjedhojë nuk mund të kenë dhe adresën zgjedhore (kodin e vendbanimit ose kodin 10 shifror) të saktë. Nga analiza e informacionit të dërguar nga DPGJC vërehen raste të shumta ku shumë votues janë të regjistruar në njëjtën adresë dhe një numër i madh votuesish me përbërës të mangët në adresë.

<b>Bashkia</b>	<b>Zgjedhes me adrese te pa sakte</b>
<b>Bashkia Tiranë</b>	102,065
<b>Bashkia Durrës</b>	60,261

<b>Bashkia Vlorë</b>	49,104
<b>Bashkia Shkodër</b>	27,720
<b>Bashkia Lezhë</b>	27,288
<b>Bashkia Fier</b>	22,289
<b>Bashkia Finiq</b>	19,966
<b>Bashkia Kurbin</b>	17,550
<b>Bashkia Sarandë</b>	16,831
<b>Bashkia Elbasan</b>	12,336
<b>Bashkia Malësi E Madhe</b>	10,248
<b>Bashkia Krujë</b>	7,888
<b>Bashkia Devoll</b>	6,765
<b>Bashkia Kuçovë</b>	6,718
<b>Bashkia Gjirokastrë</b>	6,513
<b>Bashkia Pogradec</b>	6,478
<b>Bashkia Librazhd</b>	6,020
<b>Bashkia Korçë</b>	5,755
<b>Bashkia Lushnje</b>	5,405
<b>Bashkia Rrogozhinë</b>	5,334
<b>Bashkia Patos</b>	5,311
<b>Bashkia Shijak</b>	5,287
<b>Bashkia Himarë</b>	5,210
<b>Bashkia Delvinë</b>	5,061
<b>Bashkia Dibër</b>	4,844
<b>Bashkia Gramsh</b>	4,839
<b>Bashkia Kavajë</b>	4,760
<b>Bashkia Kukës</b>	4,743
<b>Bashkia Përmet</b>	4,627
<b>Bashkia Maliq</b>	4,080
<b>Bashkia Cërrik</b>	4,037
<b>Bashkia Vau-dejës</b>	3,849
<b>Bashkia Konispol</b>	3,822
<b>Bashkia Berat</b>	3,777
<b>Bashkia Divjakë</b>	3,564
<b>Bashkia Kamëz</b>	3,386
<b>Bashkia Kolonjë</b>	3,335
<b>Bashkia Pukë</b>	3,194
<b>Bashkia Selenicë</b>	3,174
<b>Bashkia Mat</b>	3,139
<b>Bashkia Dropull</b>	3,097
<b>Bashkia Has</b>	2,932
<b>Bashkia Bulqizë</b>	2,901
<b>Bashkia Fushë-arrëz</b>	2,815
<b>Bashkia Vorë</b>	2,503

<b>Bashkia Mirditë</b>	2,327
<b>Bashkia Tropojë</b>	2,286
<b>Bashkia Mallakastër</b>	2,239
<b>Bashkia Roskovec</b>	2,184
<b>Bashkia Poliçan</b>	2,156
<b>Bashkia Memaliaj</b>	2,136
<b>Bashkia Skrapar</b>	1,965
<b>Bashkia Këlcyrë</b>	1,938
<b>Bashkia Peqin</b>	1,932
<b>Bashkia Tepelenë</b>	1,770
<b>Bashkia Klos</b>	1,590
<b>Bashkia Belsh</b>	1,370
<b>Bashkia Dimal</b>	1,193
<b>Bashkia Libohovë</b>	649
<b>Bashkia Pustec</b>	481
<b>Bashkia Prrenjas</b>	263
<b>UNKNOWN</b>	88
<b>Total</b>	<b>547,388</b>

Disa nga statistikat më të dhëna të pasakta tek njësia, ose qyteti dhe numri i zgjedhësve në të.

<b>Bashkia</b>	<b>Njesia</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Rruga</b>	<b>Zgjedhes</b>
<b>Durrës</b>	UNKNOWN	Panjohur	Rruge Panjohur	24170
<b>Kurbin</b>	UNKNOWN	Panjohur	Laç,Kurbin	5795
<b>Lezhë</b>	UNKNOWN	Lezhë	Beslidhja	3085
<b>Tiranë</b>	UNKNOWN	Panjohur	Rruge Panjohur	2787
<b>Kukës</b>	UNKNOWN	Panjohur	Kukes	2614
<b>Lezhë</b>	UNKNOWN	Lezhë	Varosh	2186
<b>Tiranë</b>	UNKNOWN	Njesia bashkiake nr. 9	Jordan Misja	2166
<b>Devoll</b>	UNKNOWN	Panjohur	Bilisht	2097
<b>Tiranë</b>	UNKNOWN	Panjohur	Selite	1968
<b>Vorë</b>	UNKNOWN	Panjohur	Rruge Panjohur	1956
<b>Kolonjë</b>	UNKNOWN	Ersekë	Zgjc Ersekë Qy Ersekë	1931
<b>Sarandë</b>	UNKNOWN	Panjohur	Lagja Nr 4	1889

Disa nga statistikat me të dhëna të pasakta tek përbërësit e adresave dhe numri i zgjedhësve për secilën adresë.

BASHKIA	NJESIA	QYTETI	RRUGA	NDERTESA	HYRJA	Apt	K_POSI	ZGJEDHES
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 1	NJËSIA BASHKIAKE NR. 1	PASHO HYSA	26/1		1	NULL	1004 359
Durrës	UNKNOWN	Arapaj	Arapaj	x	x	x	2021	305
Durrës	UNKNOWN	Arapaj	Arapaj	x	x	x	0	207
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 4	NJËSIA BASHKIAKE NR. 4	HAMDI SULÇEBE		44	1	NULL	1012 180
Librazhd	Hotofish	VULÇAN	URA E MENALLES 01400058		10	1	NULL	3408 160
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 11	NJËSIA BASHKIAKE NR. 11	RIZA ÇUKA		22	1	NULL	1026 158
Korçë	Mollaj	FLOQ	SHAHINLLARET 02450041		2	1	NULL	7017 153
Sarandë	UNKNOWN	Ksamil	Ksamil		999	0	0	0 145
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 7	NJËSIA BASHKIAKE NR. 7	E KAVAJËS	209/1		1	NULL	1023 138
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 11	NJËSIA BASHKIAKE NR. 11	GJERGJ LEGISI		42	1	NULL	1026 136
Elbasan	Elbasan	ELBASAN	AQIF PASHA 00910003		5	1	NULL	3001 135
Elbasan	Elbasan	ELBASAN	KADRI HOXHA 00910287		87	1	NULL	3001 129
Belsh	Fierzë	ÇERRAGË	FIERZE CERRAGE 01000007		1	1	NULL	3023 128
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 6	NJËSIA BASHKIAKE NR. 6	JOSIP RELA		2	1	NULL	1027 121
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 11	NJËSIA BASHKIAKE NR. 11	RIZA ÇUKA		38	1	1	1026 118
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 11	NJËSIA BASHKIAKE NR. 11	RIZA ÇUKA		38	1	1	1026 118
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 4	NJËSIA BASHKIAKE NR. 4	FARUK S. BEGOLLI		26	1	NULL	1005 114
Elbasan	Elbasan	ELBASAN	FREDERIK JORGAQI 00910168		12	1	NULL	3001 110
Tiranë	Njësia Administrative Nr. 11	NJËSIA BASHKIAKE NR. 11	GJERGJ LEGISI		15	1	NULL	1026 107
Elbasan	Elbasan	ELBASAN	AQIF PASHA 00910003		1	1	NULL	3001 102
Elbasan	Elbasan	ELBASAN	AQIF PASHA 00910003		3	1	NULL	3001 100
Durrës	UNKNOWN	Durrës	panjohur	panjohur	panjohur	panjohu	0	0 75
Tiranë	UNKNOWN	Njesia bashkiake nr. 4	5 Maji		278	0	0	0 65
Lushnje	UNKNOWN	Lushnje	Kongresi		158	0	0	9001 63
Fushë-arrëz	UNKNOWN	Fushë-Arrëz	Fushe-Arrez		1	1	1	4402 63
Kuçovë	UNKNOWN	Kuçovë	1 Maj		123	0	0	5300 59
Tiranë	UNKNOWN	Tiranë	Sadik Petrela		1	1	1	0 51

## 5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore

Në lidhje me administrimin e procesit të përgatitjes së listës së zgjedhësve konstatohet se:

1. DPGjC ka përgatitur ekstraktin e parë të listës së zgjedhësve më datë 22.11.2022, ekstraktin e dytë më datë 19.12.2022 dhe ekstraktin e tretë më datë 21.01.2023, ekstraktin e katërt më datë 19.02.2023, ekstraktin e pestë më datë 20.03.2023 dhe Listën Përfundimtare me datë 4 Prill 2023, afate të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.
2. Në përgjigje të kërkesës për procedurat e ndjekura për të përgatitur Listën Përfundimtare të zgjedhësve DPGJc vazhdon të mos ketë kthyer përgjigje të plotë.

3. Në përgjigje të kërkesës për informacion mbi rastet kur ne zbatim te Nenit 50, pika 2 se nga ana e DPGJC janë identifikuar raste te shkeljeve dhe cilat janë masat administrative te ndërmarra. DPGJC konfirmon se "Nuk janë konstatuar shkelje të cilat të ndikojnë në deformimin e përbërësve zgjedhor te zgjedhësve".
4. Kërkesës sonë për informacion në lidhje me zbatimin e nenit 52 te Kodit zgjedhor mbi "Njoffimin me shkrim i zgjedhësve" nga ana e DPGJC nuk është arritur te provohet me dokumentacion përkatës nëse është realizuar.
5. Në pamje të parë kemi rindarjen ne menyre te paqarte Qendrave te Votimit pa marre ne konsiderate vendimet e Kryetareve te Bashkive dhe ndryshimin e renditjes në to e cila ka rezultuar ne ndryshimin e Qendres se Votimit per **1,269,614** votues. Janë zbatuar përgjithësisht procedurat e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.11152, datë 28.10.2022 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore" (duke përjashtuar procedurën e rindarjes së Qëndrave të Votimit), dhe të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike" dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".



## 6. Opinion

Në përfundim të periudhës së auditimit referojmë se nuk kemi hasur vështirësi për te kryer misionin e ngarkuar sipas kodit zgjedhor.

Problematikat kryesore të evidentuara ka të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve me një numër të lartë rendor të kodeve të banesave ose pa adresa te sakta ne sistemin e DPGJC (problematikë e gjetur dhe në raportet e zgjedhjeve të meparshme) të cilat duhen bërë një kontroll i detajuar në zyrat e gjëndjes civile për të parë dokumentacion përkatës të cilat perdoren për regjistrimin e këtyre zgjedhësve

Qëndrat e votimit mbi limitin e lejuar jane rindarë me një procedurë të ndryshuar në periudhën ndërmjet ekstrakteve 2 dhe 3 me një llogjikë të paqartë dhe jokonform Kodit Zgjedhor. Kjo procedurë është ekzekutuar në sistemin qëndror pa marrë parasysh vendimet e Kryetarëve të Bashkive. Për rrjedhojë janë ndryshuar përbërësit zgjedhor të **1,269,614** zgjedhësve. Megjithëse zgjedhësit gjenden brenda zonës së qendrës së votimit atyre ju ka ndryshuar vendi i votimit. Në listën përfundimtare (Formati A, per Afishim) të publikuar pranë Qendrave te Votimi do të jetë e vështirë gjetja e emrit për shkak të renditjes sipas mbiemrit brenda qendrës se votimit dhe për pasojë një mbiemër mund të ndodhet ne disa qendra brenda Zonës se qendrës se votimit, sidomos në rastin e Zonave me shumë qendra votimi (>5), gjetja e emrit është shumë e lodhshme, pothuaj e pamundur.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile duhet të marrë masat për njoftimin e zgjedhësve dhe lehtësimin gjetjes së qendrës (vendit) të votimit për votuesit.

## 7. Shtojca

